

SIGURIA E GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK



REALITET APO KËRCËNIM I VAZHDESHËM

| Autorë | Marina Tuneva | Llazar Sandev |

Shkupi, marsh 2022

Titull:

Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatik - realitet apo kërcënim i vazhdueshëm

Autorë:

Marina Tuneva
Llazar Sandev

Botues:

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Projekt:

Gazetarë të sigurt në situata krize

Përkthyes në gjuhën shqipe:

Kristina Naceva

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Gazetarë të sigurt në situata krize” (Keeping Journalists Safe in Situation of Crisis) financuar nga programi i UNESCO - “Global Media Defence Fund”, dhe në realizim të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik.

Autorët janë përgjegjës për përzgjedhjen dhe prezantimin e fakteve të përfshira në këtë publikim dhe, për mendimet e shprehura të cilat nuk janë domosdo ato të UNESCO-s, nuk janë të detyrueshme për Organizatën.

Indikacionet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e çfarëdo mendimi nga UNESCO-ja në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti apo zone ose të autoriteteve lokale të atjeshme apo në lidhje me përcaktimin e kufijve.

Shkupi, 2022



United Nations
Educational, Scientific
and Cultural Organization



PËRMBAJTA

1.	Hyrje	4
2.	Pasojat e sulmeve dhe presioneve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik	9
2.1	Shqetësimet për sigurinë personale dhe ndikimi në gjendjen emocionale	10
2.2	Ndikimi në cilësinë e punës dhe funksionimin produktiv të mediumit	12
2.3	Përgjigja e institucioneve – nuk ka drejtësi për “27 Prillin”	13
3.	Mediat nuk e trajtojnë këtë temë në thellësi dhe publiku nuk është i informuar mjaftueshëm	15
4.	Palët e përfshira janë të njëzëshëm: praktika kërkon zbatimin e ligjit	18
5.	Analiza e rastit civil -gjqësor mbi “Të enjten e përgjakshme”	20
5.1	Aktgjykimi i plotfuqishëm H-MALVP-705/20 i Gjykatës Themelore Civile Shkup	23
5.1.1.	Analiza mbi kompensimin e dëmit jomaterial për frikën e shkaktuar	23
5.1.2.	Kompensimi i dëmit jomaterial për shkeljen e lirisë së shprehjes	28
5.1.3.	Aktgjykime të tjera	35
6.	Përfundime	37
7.	Rekomandime	40



HYRJE

Mediat e lira janë thelbësore për funksionimin e një shoqërie demokratike. Kjo do të thotë që gazetarët dhe punonjësit mediatik të bëjnë punën e tyre pa rrezik dhe frikë nga presioni, kërcënimi, shantazhi apo dhuna, por edhe të mbrohen në mënyrë adekuate nga fenomene të tilla problematike.

Në Preambulën e Rekomandimit të Këshillit të Evropës 2016 CM / Rec (2016) 4 theksohet se gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediatik kërcënohen, ngacmohen, monitorohen, frikësohen, privohen arbitrarisht nga liria, sulmohen fizikisht, torturohen dhe madje vriten gjithnjë e më shumë për shkak të punës së tyre humltuese, mendimeve ose raportimeve, veçanërisht kur këto aktivitete fokusohen në keqpërdorimin e pushtetit, korrupsionin, shkeljet e të drejtave të njeriut, aktivitetet kriminale, terrorizmin dhe fundamentalizmin¹.

Presionet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik janë të llojeve të ndryshme, duke përfshirë ato fizike, psikologjike, ekonomike etj. Ato vijnë nga një gamë e gjerë aktorësh, ndër të cilat mund të jenë qendra të ndryshme të fuqishme, duke përfshirë politikanë, biznesmenë, figura publike, bashkëbisedues armiqësor, aktivistë të mediave sociale, trollët e internetit etj.

Realiteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut konfirmon se dukuri të tilla vazhdojnë të ekzistojnë në vazhdimësi, kurse në Regjistrin e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020 janë regjistruar gjithsej 21 sulme ndaj gazetarëve dhe mediave., të cilat përfshijnë kërcënime fizike, kërcënime verbale, ngacmime, kërcënime me jetë, si dhe kërcënime ndaj mediave dhe organizatave gazetareske². Këto janë sulme të një natyre më të rëndë dhe të evidentuara në përputhje me metodologjinë për regjistrimin e sulmeve ndaj mediave dhe gazetarëve, të cilën SHGM-ja e ka harmonizuar me gjashtë shoqata të gazetarëve në vitin 2017. Sulmet dhe shkeljet tjera të të drejtave të gazetarëve dhe punëtorëve mediatik, për të cilat SHGM-ja ka reaguar publikisht në këtë periudhë, janë në numër më të madh, veçanërisht nëse supozohet se presionet dhe/ose sulmet tjera nuk janë raportuar fare.

Dukuritë e tilla ndikojnë në punën e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, në përgjedhjen e temave që do të trajtojnë, si dhe mbi mënyrën se si ata do të informojnë për to. Sulmet ndaj gazetarëve ose punonjësve mediatik mund të kenë një

1 Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2016)4 i Komitetit të Ministrave të vendeve-anëtare për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik, qasur në: https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2016-4-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-protection-of-journalism-and-safety-of-journalists-and-other-media në dispozicion prej dt. 24.01.2022

2 Spirovski, M., Todorovska – Kostovska, B. (2020). Tregues mbi nivelin e lirisë së mediave dhe mbi sigurinë e gazetarëve në vitin 2020, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

efekt frikësues ndaj të tjerëve, veçanërisht kur autorët veprojnë pa u ndëshkuar³. Ndonëse ka rënë numri i sulmeve fizike, shqetësues është fakti që në rrjetet sociale po vihen re gjithnjë e më shumë kërcënime për jetën e gazetarëve. Përveç kësaj, janë regjistruar edhe raste të diskriminimit gjinor.

SHGM-ja kërkon në vazhdimësi nga institucionet e sistemit që të garantojnë sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, kurse nga Prokuroria Publike (PP) që të veprojnë aktivisht në ndjekjen e atyre që kërcënojnë dhe i shkelin të drejtat e tyre.

Dy incidente të rënda në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndikojnë drejtpërdrejt dhe rrezikojnë sundimin e ligjit dhe lirinë e shprehjes - 24.12.2012 i ashtuquajtur “E hëna e zezë” dhe 27 prill 2017 – i ashtuquajtur “E enjtja e përgjakshme”. Karakteristikë e këtyre dy ngjarjeve është se ngjarjet kanë ndodhur në Parlament - vend ku liria e shprehjes duhet të jetë tipari suprem i demokracisë.

“E hëna e zezë” ishte një shkelje e lirisë për të marrë dhe për të dhënë informacione nën maskën e “sigurisë së gazetarëve”, ndërsa “E enjtja e përgjakshme” ishte shkelje e sigurisë së gazetarëve, si pjesë e lirisë së shprehjes, për një dhe të vetmin qëllim – mosndërmarrja e masave parandaluese të sigurisë nga shteti për të mbrojtur sigurinë e të gjithë të pranishmëve në Kuvend, përfshirë edhe gazetarët, së bashku me punonjësit e mediave (kameramanë, fotografë) që ishin të pranishëm në këtë ngjarje.

“E enjtja e përgjakshme” është ndoshta shkelja më e rëndë e lirisë së shprehjes në vend dhe përveç stresit dhe frikës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik për jetën e tyre, ka pasur edhe gazetarë që kanë pësuar lëndime fizike.

Pesë vjet pas këtij incidenti, lind sërish pyetja se sa kanë kontribuar institucionet e sistemit në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe cilat janë pasojat e mosndëshkimit për fenomene të tilla problematike. Në përpjekje për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve, janë zhvilluar intervista cilësore me pesë gazetarë dhe punonjës mediatik, siguria e të cilëve është prekur drejtpërdrejt gjatë sulmit në Kuvend, si dhe me gjashtë ekspertë vendas dhe ndërkombëtar të sferës mediatike (SHGM, IMM, SPGPM, Resis, UNESCO, Aleanca për Këshillat e Pavarur të Etikës në Evropë - AIPCE). Në të njëjtën kohë, qëllimi i kësaj analize është të përcaktojë se si korniza ligjore dhe boshllëqet kryesore sistematike kanë ndikuar në sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe lirinë e shprehjes

3 European Union Agency for Fundamental Rights (2016), Violence, threats and pressures against journalists and other media actors in the EU, Vienna, dostupno na: <https://fra.europa.eu/en/publication/2016/violence-threats-and-pressures-against-journalists-and-other-media-actors-european>, në dispozicion prej 22.01.2022.

dhe lirinë e mediave në përgjithësi. Për këtë qëllim janë analizuar dy aktvendime gjyqësore, njëra prej të cilave është plotfuqishme, kurse tjetra në procedurë ankese. Ligji për marrëdhëniet obliguese, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rishikimi i rastit të ndërhyrjes në Kuvend në vitin 2017 jep një pasqyrë të implikimeve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, si ndaj tyre, ashtu edhe ndaj cilësisë së punës së tyre. Paralelisht me analizën e legjislacionit dhe (mos)përputhjen e tij në adresimin e dukurive të tilla nga Gjykata Themelore Civile Shkup dhe Gjykata e Apelit në Shkup, analizohen edhe pasojat në mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Kjo analizë ndjek rrugën e gazetarëve në sistemin gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të tyre, konkluzionet e organeve të ndjekjes penale dhe gjykatave civile.

Fillimisht, disa nga gazetarët filluan të japin deklarata si të dëmtuar para Prokurorisë Themelore Publike Shkup (PTHP), e cila fillimisht ishte përgjegjëse për kryerjen e hetimeve për “E Enjten e Përgjakshme”. Qëllimi ishte që gazetarët të jepnin deklarata për qëndrimet e tyre për ngjarjet në Kuvend dhe identifikimin e mundshëm të njerëzve nga turma që hynë në Parlament “me dhunë”. Pas marrjes së rastit nga Prokuroria Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, nevoja për të dëgjuar gazetarët si viktime pushoi. Se përse ndodhi kjo, askush nuk ka përgjigje deri më sot, por gazetarët luajtën një rol të rëndësishëm në sigurimin e provave në Prokurori për të ndjekur penalisht ata autorë që ishin të njohur, por fatkeqësisht në ato procedura gazetarët e përfshirë nuk mundën të paraqiteshin si viktime. Kjo për arsyen e thjeshtë se ato krime, veçanërisht krimi i rrezikimit terrorist të rendit kushtetues është krim kundër shtetit, respektivisht objekti i mbrojtjes është shteti dhe institucionet e tij, ndaj çdo gazetar që ka pësuar ndonjë dëm (fizik ose psikik) mund të dëmshpërblehet gjatë procesit, por Prokuroria duhet të hapë një hetim dhe të gjejë autorët e krimeve ndaj gazetarëve. Fatkeqësisht, një lëndë e tillë nuk është hapur ende, kurse pas një bisede me gazetarët e interesuar, ata nuk janë thirrur në Prokurori për të dhënë deklaratë, me qëllim që të zbulohen autorët.

Alternativa tjetër për gazetarët ishte ngritja e padisë civile në Gjykatën Themelore Civile Shkup, me të cilën do të kërkojnë kompensim për dëmin jo-material për frikën e shkaktuar dhe për shkeljen e lirisë së shprehjes në aspektin e sigurisë së gazetarëve, që do të analizohet më poshtë si bazë e veçantë ligjore.

Pesë gazetarë/gazetare dhe dy bashkëpunëtorë mediatik kanë parashtruar

padi në Gjykatën Themelore Civile Shkup për kompensim për frikën e përjetuar dhe shkeljen e lirisë së shprehjes (siguria e gazetarëve).

Paditë janë parashtruar me iniciativë dhe me përkrahje të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), ku përmes thirrjes publike janë thirrur ata gazetarë që më 27.04.2017 kanë qenë në Kuvend që individualisht t'i mbrojnë të drejtat e tyre para Gjykata Themelore Civile Shkup, sepse Prokuroria Themelore Publike në Shkup nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për mbrojtjen e gazetarëve, e veçanërisht të atyre që janë sulmuar në Kuvend.

Gjendja aktuale deri në mars të vitit 2022 është katër padi aktive, dhe një lëndë e përfunduar ku padia e paditësit është refuzuar si e pabazuar dhe është në procedurë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga këto katër padi aktive, tre janë në ankesë në Gjykatën e Apelit të Shkupit dhe një është në proces dëgjimor të palëve.



**PASOJAT E SULMEVE
DHE PRESIONEVE
NDAJ GAZETARËVE
DHE PUNONJËSVE
MEDIATIK**

2.1 Shqetësimet për sigurinë personale dhe ndikimi në gjendjen emocionale

“**T**ek ne, në vend, gjithmonë ka pasur presione të llojeve të ndryshme mbi gazetarët. Ndonjëherë ato janë brutale dhe të drejtpërdrejta, ndonjëherë janë delikate, manipuluese. “Ky profesion është një nga më të rrezikuarit ndaj kërcënimeve dhe presioneve nga shumë anë”⁴.

Sulmet fizike dhe presioni ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik shkaktojnë shqetësim të madh për jetën dhe sigurinë e tyre në punë. Bashkëbiseduesit e intervistuar e vlerësojnë si sulmin më të rëndë në karrierën e tyre profesionale pikërisht atë që ndodhi në Kuvend më 27 prill 2017. “Gjithçka ndodhi në një institucion që supozohej të ishte gardiani i demokracisë”⁵. Gjithashtu, efektet psikologjike të sulmeve dhe kërcënimeve janë të forta. Pasojat e kësaj janë shpesh frika dhe pasiguria në kryerjen e punës.

“Seriozisht mu shkel e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit dhe siguria gjatë atyre 3 orëve e gjysmë kur isha e mbyllur në qendrën e shtypit të Kuvendit. Kam pësuar edhe lëndime fizike, shumë ofendime, provokime dhe poshtërime”⁶. “Zakonisht nuk kam frikë nga asgjë, por 27 Prilli ishte shumë stresues, i frikshëm, pati shpërthime, shok-bomba, u dëgjuan zhurma të forta”⁷.

Edhe ngacmimi online ka efekt frikësimi. “Sulmuesit ose ata që bëjnë presion dërgojnë mesazh për të gjithë gazetarët, jo vetëm drejtuar viktimave të tyre... Duhet pasur parasysh se shumica e vrasjeve të gazetarëve kanë filluar me sulme, kërcënime dhe presion”⁸.

Konsiderohet që ngacmimet online, kërcënimet dhe presionet më shpesh ndodhin tek gratë. “Të dhënat e viteve të fundit tregojnë se gratë gazetare dhe punonjëset mediatike janë më të ekspozuara ndaj sulmeve dhe kërcënimeve, veçanërisht përmes rrjeteve sociale. Së pari, sepse gazetaret, në përqindje, janë më të

4 Intervistë me Biljana Petrovska, drejtoreshë e Institutit Maqedonas të Mediave, e realizuar më dt. 10.02.2022

5 Intervistë me Natasha Stojanovska, gazetare, e realizuar më dt. 09.02.2022

6 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022

7 Intervistë me Ivan Popović, kameraman, e realizuar më dt. 05.02.2022

8 Intervistë me Adelin Hulin, UNESCO, e realizuar më dt. 08.02.2022

përfaqësuar në media. Gazetaria dalëngadalë po shndërrohet në një profesion të ashtuquajtur “femëror” dhe me vetë këtë ka edhe një sërë sulmesh ndaj tyre. Sigurisht, ka arsye të tjera që ne duhet t’i zbulojmë dhe të punojmë për të ndaluar këto sulme, fyerje dhe të ngjashme”⁹.

Gazetarët shpeshherë pësojnë ofendime dhe poshtërime kur raportojnë për tema të ndjeshme. “Përdoren kualifikime që u referohen vetëm grave, në kuptimin pejorativ, bazuar në paragjykime dhe stereotipa gjinore. Paraqitja e një fenomeni të tillë reflektohet në mënyrë indirekte në të ardhmen e tyre profesionale dhe jetën private”¹⁰.

Edhe në ngjarjen e 27 prillit 2017, gazetaret e sulmuara kanë vënë në dukje edhe fyerjet në bazë të gjinisë. “Kolegët tanë gazetarë merrnin vetëm goditje dhe sharje, ndërsa ne gazetaret morëm goditje dhe ofendime mbi bazë seksiste dhe gjinore, si dhe shprehje vulgare. Gazetarët janë gjithmonë më të ekspozuara ndaj këtij lloji sulmesh seksiste dhe vulgare në rrjetet sociale dhe në terren. “Për sa u përket sulmeve fizike, unë nuk do të bëja dallim, sepse nëse dikush vendos të sulmojë një gazetar, do ta sulmojë atë, qoftë burrë apo grua”¹¹.

Edhe pse nuk ka statistika të sakta nëse gazetaret dhe punonjëset mediatike janë më të ekspozuar ndaj sulmeve, presioneve, ngacmimeve dhe shantazheve, megjithatë “duket se mjedisi ynë është ende i tillë që gratë gazetare mund të pësojnë ofendime më të mëdha se kolegët e tyre vetëm sepse janë të gjinisë femërore”¹².

Me këto komente dhe/ose mesazhe rrallëherë kritikojnë rezultatin e tyre profesional, në krahasim me pamjen fizike, jetën private, etj. “Ata ndoshta kanë më shumë guxim të na drejtohen neve dhe kjo na shkakton problem në funksionim dhe profesionalizëm... Problemi është se askush nuk i dënon ngjarjet e tilla dhe as nuk ka reagim nga institucionet”¹³. Megjithatë, gazetarët e intervistuar mendojnë se duhet të reagohet më shpesh dhe të kërkohet zgjidhje për probleme të tilla, sepse dhuna online është edhe dhunë dhe është çështje kohe që ato mesazhe të kthehen në sulm të vërtetë. “Ngacmuesit u dërgojnë mesazh të gjithë gazetarëve, jo vetëm viktimave të tyre”¹⁴.

9 Intervistë me Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë, e realizuar më dt. 08.02.2022

10 Intervistë me Milan Spirovski, SHGM, e realizuar më dt. 09.02.2022

11 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022

12 Intervistë me Snezhana Tërpevska, eksperte mediatike, e realizuar më dt. 08.02.2022

13 Intervistë me Natasha Stojanovska, gazetare, e realizuar më dt. 09.02.2022

14 Intervistë me Adelin Hulin, UNESCO, e realizuar më dt. 08.02.2022

2.2 Ndikimi në cilësinë e punës dhe funksionimin produktiv të mediumit

Frrika nga sulmet, presionet dhe kërcënimet ndikojnë në cilësinë e raportimit dhe shkaktojnë mosbesim në gazetarinë si profesion dhe në punën mediatike në përgjithësi. “Frika e shkaktuar nga vetë kërcënimet dhe sulmet kontribuon që gazetarët dhe punonjësit mediatik të tërhiqen në situata kur nuk duhet të jetë kështu, të mos hetojnë një temë të caktuar ose të mos fillojnë të interesohen dhe të merren me disa anomali në vend”¹⁵.

Megjithatë, disa nga bashkëbiseduesit thonë se edhe dukuritë e tilla nuk i pengojnë që të vazhdojnë ta bëjnë punën e tyre në mënyrë profesionale. “Është më shumë një sfidë për mua. Ata nuk më ndalojnë. Të jem më profesioniste, më e drejtpërdrejtë, më e hapur dhe për t’i thënë gjërat më hollësisht ashtu siç janë... sa më e zëshme dhe profesionale të jem, aq më shumë qytetarët i perceptojnë gjërat ashtu siç janë realisht në këtë moçal politik”¹⁶.

Pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për kërcënime dhe sulme apo presione, ky është një problem jashtëzakonisht serioz me pasoja më të gjera. “Ato janë një problem serioz për dëshirën e gazetarit për të qëndruar në profesion dhe motivin dhe lirinë për të hulumtuar e shkruar në mënyrë kritike dhe pa frikë rreth asaj se si punojnë politikanët apo për shfaqjen e korrupsionit ose krimit”¹⁷. Kur kësaj i shtohet fakti që gazetarët janë nën presion më të madh, edhe nga strukturat udhëheqëse, por edhe nga pronarët dhe politikanët, pasojat janë edhe më të mëdha. Gazetarët përmbahen nga të folurit hapur për këto dukuri dhe rrallë raportojnë kur shkelen të drejtat e tyre themelore. Edhe pse vlerësohet se gazetarët në redaksi, në përgjithësi, kanë më shumë liri, ende ka shumë ndikime në punën e përditshme e që nuk janë edhe aq të dukshme, respektivisht ka më shumë auto-censurë sesa presione të drejtpërdrejta¹⁸. “Vetëm një gazetar i pavarur që punon pa presione, sulme dhe kërcënime mund të punojë profesionalisht dhe me cilësi. “Është e pamundur të presësh përkushtim, entuziazëm dhe cilësi nëse nuk ke liri të plotë si gazetar”¹⁹.

15 Intervistë me Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë, e realizuar më dt. 08.02.2022

16 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022

17 Intervistë me Snezhana Tërpevska, eksperte mediatike, e realizuar më dt. 08.02.2022

18 Spirovski, M., Todorovska – Kostovska, B. (2020). Tregues mbi nivelin e lirisë së mediave dhe mbi sigurinë e gazetarëve në vitin 2020, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

19 Intervistë me Biljana Petkovska, drejtoreshë e Institutit Maqedonas të Mediave, e realizuar më dt. 10.02.2022

“Në disa situata paraprakisht, para një emisioni, veçanërisht nëse presidenti i një partie politike është i ftuar, e dimë që kërcënimet do të jenë shumë më të mëdha dhe që në fillim përpiqeni të jeni më të kujdesshëm, gjë që mund të marrë formën e auto-censurës... Kur zhvilloj intervistë natyrisht nuk do ta bëj në mënyrë joprofesionale, por çdo pyetje kritike që e di se nuk do të marrë përgjigje në mënyra të ndryshme do të kritikohet dhe do të linçohem në rrjetet sociale”²⁰.

Pasojat ndihen edhe në lidhje me funksionimin e përgjithshëm të mediave. “Nëse e konsiderojmë produktin jocilësor si pjesë të punës së përgjithshme të mediave, mund të konsiderojmë se në fund ato kontribuojnë në një performancë më të keqe financiare të mediave dhe, me këtë, edhe në një situatë më të keqe financiare, gjegjësisht gjendje më të keqe të punonjësve mediatik”²¹.

2.3 Përgjigja e institucioneve – nuk ka drejtësi për “27 Prillin”

SHGM-ja dhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) vazhdimisht kërkojnë nga institucionet që të hetojnë seriozisht dhe në mënyrë efektive të gjitha sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe të ndëshkojnë përgjegjësit. Pa një qëndrim kaq të përgjegjshëm të institucioneve, sulmet do të vazhdojnë dhe do të bëhen më agresive dhe kjo mund të rrezikojë jetën e gazetarëve²². “Në kontekstin e incidenteve të 27 Prillit, shteti nuk bëri asnjë përpjekje për të vënë drejtësi ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik që u sulmuan dhe u kërcënuan. Përkundrazi, gazetarët dhe punonjësit mediatik u kushtëzuan nga shteti që drejtësinë ta kërkojnë vetë para gjykatave me padi private ndaj autorëve dhe dhunuesve të atyre ngjarjeve”²³.

Qëndrimi i institucioneve ndaj këtij problemi dënohet edhe nga organizata të tjera gazetareske dhe mediatike. “Shteti nuk i ka mbrojtur fare gazetarët dhe nuk u ka siguruar drejtësi. Gazetarët në fjalë ishin të ekspozuar ndaj kërcënimit për jetë dhe traumave psikologjike që është e vështirë të tejkalohen”²⁴.

20 Intervistë me Natasha Stojanovska, gazetare, e realizuar më dt. 09.02.2022

21 Intervistë me Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë, e realizuar më dt. 08.02.2022

22 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM dhe SPGPM: Drejtësia selektive për 27 Prillin është padrejtësi ndaj qytetarëve dhe gazetarëve”, qasur më: <https://znm.org.mk/зnm-и-сснм-селективната-права-за-27ми-а/> në dispozicion prej dt. 01.02.2022

23 Intervistë me Milan Spirovski, SHGM, e realizuar më dt. 09.02.2022

24 Intervistë me Biljana Petkovska, drejtoreshë e Institutit Maqedonas të Mediave, e realizuar më dt. 10.02.2022

Pjesa më e madhe e kritikave lidhur me rastin e 27 prillit është se gjyqësori kishte pasur qasje dhe vlerësim të ndryshëm të situatës, krahasuar me të tjerët që u sulmuan në Parlament. “Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik gjatë detyrës, sidomos nëse është legjislativi, ku shteti dhe institucionet e tij duhet të krijojnë kushte të sigurta pune doemos duhet të ndëshkohen, respektivisht në rastin tonë mendojmë se duhej vlerësuar ndryshe këto sulme ndaj punonjësve mediatik, si dhe pengimin e punës së tyre”²⁵.

Edhe pse shteti dhe pushteti aktual kanë premtuar drejtësi për ngjarjet, gazetarët dhe komuniteti profesionist mediatik mendojnë se nuk është kështu. “Në mënyrë të qartë, me zë të lartë dhe pa mëdyshje - nuk kishte drejtësi. Ligji i turpshëm për amnisti selektive nga ana e përgjegjësve të 27 prillit (e kam fjalën për deputetët e amnistuar) ishte goditja e parë për drejtësinë. Ne kemi përjetuar situata absurde në gjykata që me vetëdije kemi rrezikuar sigurinë tonë, sepse nuk kemi mbajtur helmata, apo për të mohuar se disa prej nesh janë fare kolegë. Kjo është, tekstualisht, vetëm goditja e fundit si pasojë e papërgjegjshmërisë dhe padrejtësisë së turpshme ndaj gazetarëve... është absurde dhe e turpshme të kontestohet e drejta jonë për të qenë gazetarë, se kemi pësuar frikë, tronditje, trauma, edhe pse ka raporte, ekspertiza nga ekspertët e gjykatës, se disa prej nesh nuk kanë pasur lëndime, kurse ata që kanë pasur lëndime fizike duhet të kenë mbajtur helmata”²⁶.

Gazetarët reagojnë ashpër për faktin se Prokuroria Publike vetëm në Kuvend ka iniciuar procedura ndaj politikanëve të sulmuar dhe ata vetë janë detyruar të iniciojnë konteste private civile. “Është një turp për të gjithë vendin, gjyqësorin, por edhe për politikanët që thjeshtë u zhdukën me reagimet dhe mbështetjen e tyre pasi u nis procedimi ndaj tyre. Dhe ne ishim të thirrur si dëshmitarë në Prokurorinë Publike dhe kontestet kanë humbur sërish”²⁷.

Gazetarët e përfshirë reagojnë se pavarësisht se më 27 prill 2017 janë përballur me kërcënime serioze për jetën, sërish nuk kanë pushuar së kryeri punën e tyre në mënyrë profesionale. “Ne, disa gazetarë, ishim në prag të humbjes së jetës. Unë u mbylla në një dhomë ku nuk e dija se çfarë mund të më ndodhte, por nuk ndalova ‘transmetimin’ që ajo të dilte publikisht.... Pavarësisht se atëherë ne mbronim interesat e shtetit, nuk shoh që shteti qëndroi pas asaj që na ndodhi... Shteti bëri përpjekje të mjaftueshme që të mos kishte drejtësi për gazetarët, e kundërta e asaj që duhej të ndodhte”²⁸.

Mbizotërojnë qëndrimet se pikërisht mosndëshkimi i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik shkakton incidente të këtij lloji ose rrit rrezikun e tyre.

25 Intervistë me Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë, e realizuar më dt. 08.02.2022

26 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022

27 Intervistë me Natasha Stojanovska, gazetare, e realizuar më dt. 09.02.2022

28 Ibid



**MEDIAT NUK E
TRAJTOJNË KËTË
TEMË NË THELLËSI
DHE PUBLIKU NUK
ËSHTË I INFORMUAR
MJAFTUESHËM**

Përshtypja e përbashkët e bashkëbiseduesve të intervistuar është se mediat në vend nuk informojnë mjaftueshëm dhe në mënyrë të rregullt për problemet e sigurisë dhe presionet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Prandaj, publiku nuk është i vetëdijshëm sa duhet për këto probleme.

“Mendoj se publiku i gjerë ka një opinion negativ për gazetarinë si profesion dhe se pikërisht në atë kontekst i sheh kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve. Nëse publiku mendon se gazetarët janë përgjithësisht joprofesionistë, atëherë ka shumë të ngjarë që ata të mos shqetësohen apo të mos jenë të interesuar për sigurinë e gazetarëve”²⁹. Prandaj nuk dihen problemet me të cilat ballafaqohen gazetarët dhe punonjësit mediatik. “Shumë gjëra u ndodhin njerëzve gjatë ditës që i prekin ata më shumë sesa ato që na ndodhin neve si grup”³⁰.

“Unë shumë herë kur kam qenë në terren u kam thënë njerëzve se ishte njësoj si kur dikush u vjen në punë dhe u kërcënon në mënyrë verbale. E bëj punën time, filmoj, më sulmojnë verbalisht apo fizikisht, nuk e kuptojnë se çfarë po bëjnë me të, nuk e kuptojnë profesionin tonë, veprojnë në mënyrë agresive...”³¹.

SHGM-ja në vazhdimësi u përgjigjet sfidave dhe problemeve që ndërlidhen me këto çështje dhe “në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë punon në hulumtime, analiza krahasuese dhe përgatit publikime në interes të publikut, përkatësisht informimin e qytetarëve për këto probleme”³². Analizat e SHGM-së janë përfshirë në vazhdimësi në raportet për Komisionin Evropian. Më konkretisht, bazuar në të dhënat e SHGM-së, në raportin e vitit 2021³³ thuhet se janë raportuar dy sulme fizike dhe 12 forma të ndryshme të kërcënimit verbal ndaj jetës dhe frikësimit.

Madje edhe kur raportohet për këto probleme në media, thelbi i tyre rrallë vihet në dukje. Zakonisht informohet për përvjetorin e një ngjarjeje, për një padi, për një konferencë për shtyp të SHGM-së dhe shoqatave të tjera mediatike, nëse ka ndonjë incident të rëndësishëm ose nëse është sulmuar ndonjë ekip. “Zakonisht ne i zgjidhim problemet e të tjerëve, por jo tonat... Ne gjithmonë shkojmë me diçka që është çështje më e rëndësishme dhe më me ndikim të interesit qytetar. Ne vet e vendosim veten në margjinat e raportimit. Mendoj se qytetarët nuk janë plotësisht të njoftuar se çfarë ndodhi në ditën më të errët të demokracisë ma-

29 Intervistë me Snezhana Tërpevska, eksperte mediatike, e realizuar më dt. 08.02.2022

30 Intervistë me Natasha Stojanovska, gazetare, e realizuar më dt. 09.02.2022

31 Intervistë me Ivan Popović, kameraman, e realizuar më dt. 05.02.2022

32 Intervistë me Milan Spirovski, SHGM, e realizuar më dt. 09.02.2022

33 Komisioni Evropian (2021) Raport për Republikën e Maqedonisë së Veriut, qasur në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en, prej dt. 25.01.2022

qedonase dhe çfarë përjetuam ne gazetarët. Sikur jemi qytetarë të dorës së dytë dhe si të tillë trajtohem edhe në vendimet gjyqësore³⁴.

Bashkëbiseduesit vlerësojnë se fokusi në mënyrën e raportimit në media është kryesisht te politika dhe tema të tjera që tërheqin publikun, ndërsa situata me sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve nuk konsiderohet një temë shumë tërheqëse. “Sikur ka një rregull të pashkruar që të mos shkruash për gazetarët dhe mediat e tjera”³⁵.

Disa nga punonjësit mediatik vlerësojnë se “arsyet për këtë trajtim të temave nga redaksitë janë shpesh interes ekonomik i pronarëve të mediave”³⁶.

Përveç faktit që mediat duhet t’u kushtojnë më shumë rëndësi këtyre temave, nevojiten edhe protokolle të brendshme, dokumente, trajnime dhe informacione për punonjësit, të cilat do t’i ndihmojnë ata të sillen në mënyrë të duhur kur raportojnë ngjarje të rrezikshme ose të përballen me sulme, kërcënime, ngacmime, pavarësisht nëse janë online apo jo. “Është shumë më e rëndësishme që mediat, gazetarët dhe punonjësit mediatik të përpiqen ta bëjnë punën e tyre sa më objektivisht dhe të përpiqen të afrohen me qytetarët për të hequr famën se të gjitha mediat nuk bëjnë dhe janë përfaqësuese të gjithçkaje që është negative dhe e keqe në shoqëri.”³⁷

Solidariteti ndërmjet gazetarëve dhe punonjësve mediatik, kur bëhet fjalë për mbrojtjen nga sulmet, vlerësohet në nivel të kënaqshëm. “Nga përvoja ime e deritanishme, nuk ka pasur asnjë situatë që ne të mos mbrohemi apo dikush të mbetet pas dhe të tjerët të ikin”³⁸.

“Sa më i bashkuar dhe solidar të jetë komuniteti, më profesional dhe më i fortë në radhët e veta, aq më i fortë do të jetë përballë të gjitha presioneve dhe goditjeve të politikanëve, të fuqishmëve të biznesit, madje edhe atyre që i japin vetes të drejtën të sulmojnë profesionin, sepse sulmi ndaj një gazetari është një sulm ndaj të gjithë komunitetit të gazetarisë”³⁹.

34 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022

35 Intervistë me Snezhana Tërpevska, eksperte mediatike, e realizuar më dt. 08.02.2022

36 Intervistë me Trajçe Ilievski, e realizuar më dt. 03.02.2022

37 Intervistë me Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë, e realizuar më dt. 08.02.2022

38 Intervistë me Trajçe Ilievski, e realizuar më dt. 03.02.2022

39 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022



**PALËT E PËRFSHIRA
JANË TË NJËZËSHËM:
PRAKTIKA KËRKON
ZBATIMIN E LIGJIT**

Bashkëbiseduesit e intervistuar vlerësojnë se gjithmonë ka hapësirë për përmirësim të legjislacionit, por siç thonë ata, “Republika e Maqedonisë së Veriut njihet si një nga vendet me ligje të mira, por ato nuk zbatohen në praktikë. Kjo është një nga vërejtjet që marrim vazhdimisht në çdo sferë”⁴⁰

SHGM-ja vlerëson se Kodi Penal duhet të ndryshohet në mënyrë që të ketë garanci sistematike lidhur me sigurinë e gazetarëve. Për këtë çështje, së bashku me SPGPM po punon prej disa vitesh. Gjithashtu, SHGM-ja në vazhdimësi po kërkon Njësi të specializuara në Gjykatën Penale dhe Prokurorinë për të rritur efikasitetin në mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve. Zbatimi i reformave sistematike në sektorin mediatik, në kontekst të ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal, i cili siguron mbrojtje sistematike të gazetarëve në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, si dhe Ligjit për përgjegjësinë civile ndaj shpifjes dhe fyerjes, me të cilin është reduktuar dëmi jomaterial për gazetarët që në korrik 2021, ishin futur në procedurë parlamentare dhe pritet të miratohen gjatë vitit 2022.

Një nga problemet e këtij ligji është se sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik nuk procesuohen dhe thuajse gjithmonë drejtohen që drejtësinë ta kërkojnë vetë në gjykatë, duke bërë kallëzime penale. Ose, konsiderohet se çështja ka ngecur në Prokurori. “Prandaj, vlerësojmë se me miratimin përfundimtar të ndryshimeve në Kodin Penal, të cilat sulmin ndaj një gazetari apo punonjësi mediatik do ta konsideronin sulm ndaj një personi zyrtari, gjërat në këtë fushë do të ndryshonin ndjeshëm”⁴¹. Komuniteti profesionist mediatik beson se miratimi i kësaj zgjidhjeje ligjore do të jetë një hap serioz përpara në uljen e mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Disa gazetarë janë të përmbajtur dhe vlerësojnë se ideja me ndryshimet e reja ligjore do të ndryshojë situatën, por mbetet të shihet se si do të funksionojë kjo. “Përsëri ndryshimi do të duhet të vijë direkt nga partitë. Sepse burimi i problemeve është aty, nuk ka tjetër. Gjithçka është e motivuar politikisht. Edhe kërcënimet janë të njëjta”⁴².

40 Intervistë me Dushica Mërgja, gazetare, e realizuar më dt. 02.02.2022

41 Intervistë me Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë, e realizuar më dt. 08.02.2022

42 Intervistë me Natasha Stojanovska, gazetare, e realizuar më dt. 09.02.2022



**ANALIZA E RASTIT
CIVIL - GJYQËSOR
MBI “TË ENJTEN E
PËRGJAKSHME”**

Në vazhdim do të japim një pasqyrë të vogël të gjendjes faktike, për të sqaruar disa dilema juridike të cilat do të analizohen më poshtë.

Gazetarët, në ditën kritike të 27 prillit 2017, kanë ardhur për të raportuar për zhvillimet rreth zgjedhjes së shumicës së re parlamentare dhe kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtën kohë, para Kuvendit ka pasur një tubim publik, ku kanë marrë pjesë një numër i madh i njerëzve të pakënaqur nga situata politike, diçka e zakonshme në atë kohë.

Dihet, gjithashtu, se në një moment në sallën plenare të Kuvendit ka pasur tension mes deputetëve, që ka rezultuar me miratimin e shumicës së re parlamentare dhe zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit. Pas atmosferës së tensionuar, deputetët e pranishëm dhe gazetarët janë drejtuar drejt sallës së konferencave për shtyp. Gjatë fjalimit të deputetit të atëhershëm Zoran Zaev, në ekranet televizive të vendosura në qendrën e shtypit është transmetuar drejtpërdrejt tubimi publik para Kuvendit. Në një moment, ishte e qartë se turma po bëhej e dhunshme dhe se nuk kishte mjaft policë për të ruajtur godinën e Kuvendit. Në moment të caktuar, turma duke i kapërcyer pengesat e vendosura në oborrin e Kuvendit, është drejtuar drejt derës së përparme, e cila sigurohej nga një korridor i përbërë nga disa punonjës policie. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, konferenca për shtyp në Kuvend ka vazhduar pasi askush nuk ka shpresuar se turma do të lejohej të hynte në Kuvend. Në një moment dyert e Kuvendit janë hapur nga brenda nga deputeti Kërsto Mukovski dhe turma ka filluar të hyjë në Kuvend.

E gjithë kjo u transmetua drejtpërdrejt përmes disa shtëpive mediatike. Në ato momente të gazetarët e pranishëm ka mbisunduar ndjenja e mosbesimit që policët dhe sigurimi parlamentar e kishin lejuar, gjegjësisht nuk kishin bërë asgjë për të penguar hyrjen në ndërtesën e Kuvendit. Turma u shpërnda shpejt dhe mbërriti në sallën e shtypit pak më vonë. Ndonëse u bënë përpjekje për të parandaluar hyrjen e turmës në sallën e shtypit, ato rezultuan të pasuksesshme, ku turma e hapi derën me dhunë dhe kanë filluar të hedhin sende mbi të pranishmëve në sallën e shtypit, përfshirë edhe gazetarët.

Pothuajse të gjithë gazetarët që u gjendën në vendngjarje apo donin të largoheshin, u pyetën nga turma që e sulmoi Parlamentin se në cilën media janë të punësuar dhe se nëse nuk janë nga mediat e zgjedhjes së tyre, do të sulmohen. Me pak fjalë, ata ishin të ekspozuar ndaj torturave. Disa nga gazetarët u njohën/identifikuan, gjithashtu, nga turma dhe për pasojë u dhunuan fizikisht dhe në formë psikike, u sekuestruan mikrofonat, madje u mbyllën në ambientet bren-

da. Edhe një gazetar, kundër dëshirës së tij, u vendos si mburojë përballë deputetëve që kanë qenë të sulmuar.

Ajo që e përkeqëson situatën është fakti se gazetarët janë nxjerrë jashtë Kuvendit pas më shumë se tre orë pas ngjarjes, e disa janë nxjerrë më vonë.

E gjithë kjo rezulton me pasoja edhe për shëndetin psiko-fizik të gazetarëve, ku nga një gjendje e qetë raportimi, papritur janë gjendur në një situatë ku nuk e kanë ditur nëse do të maltretohen, rrihen apo edhe privohen nga jeta. E gjithë kjo si pasojë e dështimit të shtetit për të ndërmarrë veprime parandaluese në drejtim të angazhimit të një numri të mjaftueshëm të punonjësve të policisë për të siguruar Kuvendin si organin më të lartë shtetëror.

Si pasojë e ngjarjeve të asaj dite, gazetarët kanë përjetuar stres me intensitet dhe frikë të fortë, pasuar nga një reagim i zgjatur i durimit mendor. Për më tepër, disa prej tyre...

Sa për kujtesë, është fakt i pakontestuar se gjatë asaj periudhe pati një numër të madh tubimesh dhe demonstratash publike, gjatë të cilave shteti përdorte pajisje dhe forcë për shpërndarjen e turmës për protesta paqësore, me qëllim që ato të mos dëmtonin Kuvendin apo për të hyrë në të. Por atë ditë, 27.04.2017, është dita kur shteti nuk i ka marrë masat e nevojshme parandaluese për mbrojtje, për çka Gjykata Themelore Penale ka nxjerrë aktgjykim me të cilin janë shpallur fajtorë për veprën penale të kërcënimit terrorist të rendit kushtetues disa persona, përfshirë edhe mbajtësit të funksioneve publike si organizatorë të kësaj ngjarjeje.

Siç u përmend më lart, pesë gazetarë/gazetare dhe dy bashkëpunëtorë mediatik kanë paraqitur padi në Gjykatën Themelore Civile Shkup. Paditë bazoheshin në dy baza: kompensim për dëmin jomaterial të shkaktuar - frikë e pësuar dhe kompensim për dëmin jomaterial për shkelje të lirisë së shprehjes nga aspekti i sigurisë së gazetarëve. Edhe pse gjendja faktike është e njëjtë në të dy bazat, në vijim do të shtjellojmë bazat ligjore për shkak të dilemave juridike që dalin nga Ligji për marrëdhëniet obliguese dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, lidhur me sigurinë e gazetarëve si pjesë e lirisë së shprehjes.

5.1 Aktgjykimi i plotfuqishëm H MALVP-705/20 i Gjykatës Themelore Civile Shkup

5.1.1. Analiza mbi dëmshpërblimin e dëmit jomaterial për frikën e shkaktuar

Në Ligjin për marrëdhëniet obliguese (në tekstin e mëtejme LMO), kapitulli 6 me titull “Rastet e veçanta të përgjegjësisë” është neni 166 me titull: Përgjegjësia për akte terroriste, demonstrata publike ose manifestime, ku thotë:

- (1) Për dëmin e shkaktuar nga vdekja, lëndimi trupor ose dëmtimi, gjegjësisht shkatërrim i pasurisë së personit fizik ose juridik, për shkak të akteve të dhunës ose terrorit, si dhe gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike, përgjigjet shteti, pa marrë parasysh ekzistimin e fajit, përveç rasteve kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj.
- (2) Organizatorët, pjesëmarrësit, nxitësit dhe ndihmësit në aktet e dhunës ose terrorit, në demonstratat dhe manifestimet publike, të cilat kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, nuk kanë të drejtë në kompensim sipas kësaj baze.
- (3) Shteti ka të drejtë dhe obligim që nga personi që e ka shkaktuar dëmin të kërkojë kompensimin e shumës së paguar.
- (4) Kjo e drejtë vjetërsohet në afatet e parapara për vjetërsimin e kërkesave për kompensim të dëmit.

Siç mund të konstatohet nga teksti i nenit, në situatat e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, e që janë akte dhune ose terrori, si dhe gjatë demonstratave dhe manifestime publike, shteti përgjigjet gjithmonë pa marrë parasysh fajin, përveç nëse me ligj tjetër nuk është parashikuar ndryshe. Kjo është e ashtuquajtur përgjegjësi objektive, respektivisht në një situatë nëse shteti i gjen dhe i dënon per-

sonat që e kanë shkaktuar dëmin, shteti është sërish përgjegjës, sepse ka qenë i detyruar të mbrojë pronën dhe shëndetin e qytetarëve. Por, një shënim dhe ndryshim i rëndësishëm. Ngjarja e 27 prillit nuk ishte e dhunshme në vetvete. Gazetarët raportuan nga një atmosferë e qetë, normale në Kuvend dhe supozohet se Kuvendi është gjithmonë i mbrojtur nga çdo sulm. Prandaj dhe si bazë për ngritjen e padisë është ky nen 166 i LMO-së. Megjithatë, gazetarët janë të detyruar të ndjekin udhëzimet e punonjësve të rendit kur raportojnë në situata dhune, siç është raportimi nga demonstrata publike apo të ngjashme, sepse në këtë mënyrë shteti e mbron gazetarin nga lëndimi.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe nenin e lartpërmendur të Ligjit, megjithatë, gjykata u përball me dilemë nëse mund të jepet kompensimi për dëmin jomaterial - frika e pësuar, sepse në tekstin e paragrafit 1 janë renditur në mënyrë taksative arsyet mbi të cilat do të mund të pretendohet dëmi, e këto janë: “dëmi i shkaktuar nga vdekja, lëndimi trupor ose dëmtimi, gjegjësisht shkatërrimi i pasurisë së personit fizik ose juridik”.

Teza juridike e gazetarëve në procedurën civile është se ky nen i ligjit nuk mund të interpretohet kaq kufizues, sepse teksti përmban edhe fjalën dëm, që nënkupton dëm në kuptimin e përgjithshëm, kurse dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i rritjes së tij (dobia e humbur), si dhe cenimi i të drejtave personale (dëmi jomaterial) (shih nenin 142 të Ligjit për marrëdhëniet obliguese).

Teza juridike e mbrojtjes së shtetit është se nuk mund të ketë kompensim për dëmin jomaterial nga frika e pësuar sepse neni 166 i LMO-së nuk e mbulon atë dëm, se nëse kërkohet një dëm i tillë duhet të ketë lëndim trupor dhe se shteti nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet e ndërmarra nga një tjetër.

Gjatë gjykimeve për të gjithë gazetarët, është dorëzuar Mendim Juridik i Departamentit për Çështje Civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e diskutimit të një çështjeje juridike me interes për punën e të gjitha këshillave në gjykatë dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 22.02.2011, në të cilën u miratua:

“Përcaktimi i përgjegjësisë, llojit, vëllimit dhe masës së dëmit të shkaktuar në kuptim të dispozitës së nenit 166 “Përgjegjësia për akte terroriste, demonstrime publike apo manifestime” të Ligjit për marrëdhënie obliguese përcaktohet në përputhje me këtë dispozitë dhe dispozitat e tjera të të njëjtit ligj i kapitullit 2, i titulluar - Shkaktimi i dëmit, nga neni 141 deri në nenin 198”.

Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut u jep mendim juridik të gjitha gjykatave themelore dhe të Apelit se nëse ka ndonjë dëmtim të shëndetit dhe pronës në aktet e dhunës apo terrorit, si dhe në demonstratat dhe manifestimet publike, shteti përgjigjet, respektivisht është i detyruar të kompensojë dëmin e shkaktuar.

Në kontekstin e frikës së pësuar si bazë për kompensimin e dëmit jomaterial, Ligji për marrëdhënie obliguese, përkatësisht neni 189 paragrafi 1 dhe 2 parasheh:

“(1) Në rast të shkeljes së të drejtave personale, gjykata, nëse konstaton se ashpërsia e shkeljes dhe rrethanat e çështjes e justifikojnë atë, do të caktojë një dëmshpërblim të drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, si në mungesë të tij”.

“(2) Me rastin e vendosjes për kërkesën për kompensim të drejtë në të holla, gjykata do të marrë parasysh forcën dhe kohëzgjatjen e lëndimit që ka shkaktuar dhimbje fizike, dhimbje mendore dhe frikë, si dhe qëllimin për të cilin është bërë kompensimi, por edhe rreth asaj dëmshpërblimi të mos jetë në kundërshtim me aspiratat që nuk përputhen me natyrën dhe qëllimin e tij shoqëror”.

Shtrohet përsëri pyetja - Çfarë do të thotë kjo? Nga paragrafi 1 i nenit 189 mund të konkludohet se gjykata mund të caktojë kompensimin nga frika e pësuar dhe në mungesë të dëmit material (ekzistenca e lëndimit trupor), ndërsa paragrafi 2 parasheh se gjykata me rastin e vendosjes për kompensim të drejtë në të holla duhet të marrë parasysh forcën dhe kohëzgjatjen e dëmtimit që ka shkaktuar dhimbjen fizike, dhimbjen mendore dhe frikën, si dhe për qëllimin për të cilin bëhet kompensimi, por edhe që dëmshpërblimi të mos jetë në kundërshtim me aspiratat që nuk përputhen me natyrën dhe qëllimin e tij shoqëror.

Por, megjithatë, katër nga pesë padi janë refuzuar për faktin se gazetarët nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga frika e shkaktuar, pasi nuk kanë pësuar lëndime trupore. Padia e pestë është ende në pritje. Në vijim do të analizojmë disa nga këto aktgjykime.

Siç përmendëm më lart, me këtë aktgjykim, në pjesën për kompensimin e frikës së pësuar, padia është refuzuar si e pabazuar për shkak se paditësi-gazetar nuk ka pësuar lëndime trupore. Arsyetimi i Gjykatës Themelore Civile Shkup është si vijon:

“Kërkesën për kompensimin e dëmit jomaterial për frikën e pësuar paditësi e kërkon sipas nenit 166 paragrafi 1 i LMO, andaj duke pasur parasysh dispozitën del qartë se i padituri, pra. Shteti përgjigjet vetëm për dëmet e shkaktuara nga vdekja, lëndimi trupor ose dëmtimi, gjegjësisht shkatërrimi i pasurisë së personit fizik ose juridik për shkak të akteve të dhunës. Si pasojë e ngjarjes së datës 27.04.2017, paditësi jo vetëm që nuk ka pësuar lëndim trupor, por nuk ka asnjë dëm në pronën e tij, ndaj nga frika se ka pësuar paditësi, dhe për gjykatën është i padiskutueshëm (sepse është normale që çdo person të përjetojë frikë, por deri në çfarë mase varet nga karakteri i personit, dhe gjendja e tij emocionale) i padituri nuk është i detyruar të paguajë dëmshpërblim për dëmin jomaterial, sepse dispozita ligjore në mënyrë taksative i përcakton arsyet mbi të cilat e paguan kompensim, kurse frika si e tillë nuk është përfshirë me dispozitën”.

“Prandaj, gjykata është e mendimit se frika e tillë, në mungesë të lëndimit trupor, është juridikisht e rëndësishme për kompensimin e dëmit jomaterial, por vetëm nga personat që e kanë shkaktuar ngjarjen. Për më tepër, sa më sipër buron nga vetë dispozita se shteti është i detyruar të paguajë dëmshpërblim për lëndimet e pësuar trupore, që është përcaktuar në nenin 189 paragrafët 1 dhe 2 të LMO-së”.

“Demonstratat dhe manifestimet publike konsiderohen ngjarje që shteti duhet t’i mbajë nën kontroll dhe i njëjti është i detyruar të kujdeset për sigurinë e integritetit të popullit, sepse për shkelje të rënda të integritetit është paraparë përgjegjësi dhe shteti është i detyruar të kujdeset për të mos ardhur deri në akte terrorizmi dhe demonstrata të dhunshme. Në këtë rast, konsiderohet se integriteti i njeriut është i mirë i rëndësishëm dhe nuk mund të lihet pa kompensim, përgjegjësia është objektive. “Sipas llojit të pasurisë që i nënshtrohet mbrojtjes, integriteti fizik i paditësit nuk është cenuar, ndaj i padituri nuk mund të mbajë përgjegjësi kur paditësi nuk ka pësuar dëm”.

“Kjo që u theksua më lartë është edhe qëndrim i Gjykatës së Apelit Shkup, lidhur me konfliktin e armatosur në fshat. Haraçinë e shprehur në vendimin GZ nr. 2143/10 të datës 15.09.2010, ku Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve për kompensimin e dëmit jomaterial dhe ka vlerësuar se ata nuk kanë të drejtë në kompensim për dëmin jomaterial për dhimbje mendore të pësuar për shkak të cenimit të lirisë ose të drejtave të personit, frikës dhe cenimit të reputacionit në përputhje me dispozitat e nenit 189 cc. (në lidhje) me nenin 166 të LMO.

Gjykata e Apelit ka konstatuar se paditësit nuk kanë pësuar lëndime trupore apo vdekje për shkak të akteve të dhunës nga konflikti i armatosur i ndodhur në atë kohë, ndaj paditësit nuk kanë pasur të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial për shkeljen e këtyre të drejtave, për të cilat shteti nuk është përgjegjës”.

Pas parashtrimit të ankesës me kohë, Gjykata e Apelit në Shkup e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore Civile të Shkupit për të njëjtat arsye siç janë cekur edhe këtu.

Nisur nga arsyet e refuzimit të kërkesës së gazetarit paditës, nuk do të pajtoheshim me sa vijon:

Ky konkluzion i gjykatës së shkallës së parë për nenin 166 cc neni 189 paragrafët 1 dhe 2 është konfuz. A do të thotë gjykata e shkallës së parë se ata mund të kërkojnë dëmshpërblim vetëm nëse janë sulmuar nga persona të identifikuar nga shteti si pjesë e turmës? Po sikur shteti të mos i identifikojë ata njerëz? Kjo do të thotë kjo se gazetari nuk ka të drejtë në dëmshpërblim (material apo jomaterial)? Gjithashtu është e paqartë pse gjykata e lidhi një konkluzion të tillë me nenin 189 paragrafët 1 dhe 2 të LMO? Nëse qëllimi ka qenë që të lidhet me nenin 166 paragrafi 1 të LMO, atëherë kërkesa është e gabuar. Në një situatë të tillë, zbatimi i nenit 166 me nenin 189 paragrafi 1 do të ishte i justifikuar, duke pasur parasysh peshën e lëndimit dhe rrethanat e rastit. Pësia e lëndimit është frika e shkaktuar, e cila realisht ka ekzistuar, sepse ka pasur kërcënime të drejtpërdrejta dhe mundësi reale për shkaktimin e lëndimeve, në një vend dhe rrethanë që nuk duhej të ndodhte, pra ku shteti duhej të merrte masa të menjëhershme për të parandaluar një dhunë të tillë.

Së dyti, është e paqartë pse edhe Gjykata Themelore Civile Shkup edhe Gjykata e Apelit Shkup e barazojnë ngjarjen e “E Enjtes së Përgjakshme” me konfliktin e armatosur në Haraçinë? Është absolutisht juridike që të zbatohet e drejta e njëjta për një situatë të ngjashme apo të njëjtë faktike. Nuk është e drejtë të bëhet një analogji për të drejtën nga dy situata të ndryshme faktike. Këto dy situata faktike janë të kundërta dhe nuk mund t’i nënshtrohen të njëjtës analogji juridike.

Së treti, nuk është arsyetuar pse Gjykata Themelore Civile Shkup dhe Gjykata e Apelit Shkup nuk e kanë marrë parasysh mendimin juridik të Departamentit për

lëndë civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut⁴³. Mendimi juridik i Gjykatës Supreme ka për qëllim të ndikojë mbi gjykatat më të ulëta (Themelore dhe të Apelit) për avancimin e praktikës gjyqësore për zbatim të harmonizuar të ligjeve.

Po ashtu, ekzistojnë edhe aktgjykime të tjera nga gjykatat tjera themelore të Republikës, siç është për aksidentin e trafikut ku është miratuar kërkesa paditëse e paditësit për frikën e pësuar, në mungesë të lëndimit trupor.

Për në fund, dr. Milka Ristova, ish-gjyqtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në veprën e saj profesionale “Kompensimi i dëmit jomaterial”, të publikuar në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut⁴⁴, lidhur me frikën si formë e veçantë e kompensimit të dëmit jomaterial do të nënvizojë:

“Frika nuk do të thotë se duhet të shkaktohet doemos nga lëndimi trupor, ajo mund të shkaktohet nga veprime të tjera si formë e veçantë e çrregullimit mendor.”

5.1.2. Kompensimi i dëmit jomaterial për shkeljen e lirisë së shprehjes

Baza tjetër e padisë së gazetarëve është konstatimi i shkeljes së lirisë së shprehjes, e cila përveç të drejtës për të transmetuar dhe marrë informacione, mbron edhe sigurinë psiko-fizike në ushtrimin e kësaj të drejte.

Në nenin 3 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për media është përshkruar se çfarë përbën liria e shprehjes:

“(1) Garantohet liria e shprehjes dhe liria e mediave.”

“(2) Liria e mediave përfshin në veçanti: lirinë e shprehjes së mendimeve, pavarësinë e mediave, lirinë e grumbullimit, kërkimit, publikimit, përzg-

43 “Përcaktimi i përgjegjësisë, llojit, vëllimit dhe masës së dëmit të shkaktuar në kuptim të dispozitës së nenit 166 “Përgjegjësia për akte terroriste, demonstrime publike apo manifestime” të Ligjit për marrëdhënie obliguese përcaktohet në përputhje me këtë dispozitë dhe dispozitat e tjera të i njëjti ligj i kapitullit 2, i titulluar - Shkaktimi i dëmit, nga neni 141 deri në nenin 198”. Mendimi juridik i Departamentit për lëndë civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e diskutimit për çështjen juridike me interes të punës së të gjitha këshillave në Gjykatë dhe barazimin me praktikën gjyqësore, në seancën e mbajtur më dt. 22.02.2011

44 Ristova, M. (2013) Kompensimi i dëmit jomaterial, qasur në: <https://bit.ly/3MKoXMG> prej dt. 28.01.2022

jedhjes dhe transmetimit të informacionit me qëllim të informimit të publikut, pluralizmin dhe diversitetin e mediave, lirinë e rrjedhës së informacioneve dhe hapjes së mediave për mendime, besime dhe përmbajtje të ndryshme, akses në informacione publike, respektim i individualitetit, privatësisë dhe dinjitetit njerëzor, liria e krijimit të subjekteve juridike për kryerjen e veprimtarisë së informimit publik, shtypjes dhe shpërndarjes së mediave së shtypura dhe media të tjera nga vendi dhe jashtë vendit, prodhimit dhe transmetimit të programeve audio/audiovizuale, pavarësinë e redaktorit, gazetarit, autorëve apo krijuesve të përmbajtjeve apo bashkëpunëtorëve të programeve dhe personave të tjerë, në përputhje me rregullat e profesionit.”

Liria e shprehjes, në kuptimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm KEDNJ) të Këshillit të Evropës nuk nënkupton vetëm lirinë për të transmetuar dhe marrë informacione të një natyre politike ose tjetër, por edhe imazhe, fotografi, humor dhe satirë, shfaqje dhe të gjitha format e tjera të shprehjes.

Neni 10 i KEDNJ thotë:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.”

“2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Që këto forma të shprehen pa asnjë frikë, neni 10 i KEDNJ-së i imponon shtetit të ashtuquajturat obligime pozitive që synojnë mbrojtjen e lirisë së shprehjes, në rastin konkret sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Çfarë do të thotë ky obligim? Sipas interpretimeve të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm GJEDNJ) do të nënvizojë: “shtetet janë të obliguara të krijojnë klimë të përshtatshme për pjesëmarrje në debatet publike për të gjitha personat e interesuar, duke u mundësuar që t’i shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa frikë⁴⁵”, si dhe se askush nuk do të cenojë sigurinë e tyre gjatë transmetimit të informacioneve me karakter publik.

Si e vlerëson GJEDNJ-ja nëse ka një obligim pozitiv?

Gjatë vendimmarrjes nëse ekziston obligim pozitiv sipas nenit 10, duhet të merret parasysh:

- lloji i të drejtave të shprehjes në fjalë;
- aftësia e tyre për të kontribuar në debatet publike;
- natyra dhe shtrirjen e kufizimeve në të drejtat e shprehjes;
- aftësia e vendeve alternative të të shprehurit; dhe
- pesha e të drejtave kontradiktore të të tjerëve ose publikut.⁴⁶

Kjo do të thotë se shteti duhet të krijojë në mënyrë parandaluese një atmosferë në të cilën gazetarët do të ndihen të sigurt për të ushtruar lirinë e tyre të shprehjes, pa mundur askush tjetër të cenojë jetën dhe trupin e gazetarëve në ushtrimin e kësaj lirie. Gazetarët, sipas definicionit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë mbrojtës të demokracisë⁴⁷ ose pushteti i 4-ët. Një nga detyrat e gazetarisë është të korrigojë padrejtësinë, të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të zbulojë korrupsionin dhe të jetë shtytëse e një shoqërie më të drejtë.

Në rastin e Özgür Gündem v. Turkey, viti 2000, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në paragrafin 43 do të theksojë:

“Gjykata rikujton rëndësinë e lirisë së shprehjes si parakusht për një demokraci funksionale. Në të vërtetë, ushtrimi efektiv i kësaj lirie nuk bazohet vetëm në detyrimin e shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të krijojë edhe masa mbrojtëse pozitive, madje edhe në sferën e marrëdhënieve ndërmjet individëve. Për të përcaktuar nëse ka një detyrim pozitiv, duhet parë nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë midis in-

45 Dink v. Turkey, § 137

46 Appleby and Others v. the United Kingdom, §§ 42-43 and 47-49

47 Observer and Guardian vs. United Kingdom, 1991;

teresit publik në shoqëri dhe interesit të individit, diçka që është cilësi e Konventës. Shtrirja e këtij detyrimi do të ndryshojë në mënyrë të pashmangshme, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e situatave në Shtetet Kontraktuese, vështirësinë në krijimin e politikave të shoqërive moderne dhe zgjedhjet që duhen bërë në varësi të prioriteteve dhe burimeve. Por, një detyrim i tillë nuk duhet të interpretohet në një mënyrë që imponon një barrë të pamundur ose joproporcionale për autoritetet”.

Në një rast tjetër, *Dink v. Turkey*, viti 2010, ishte vrasja e gazetarit Firat Dink, i njohur me nofkën Hrant Dink, vrasje kjo e cila ndodhi në një kohë kur ai ishte duke u paditur për njollosje ndaj turqizmit - një proces gjyqësor i nisur me kërkesë të një grupi nacionalist. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi një shkelje të nenit 10 në kuptimin që procedurat kundër tij, e kombinuar me mungesën e mbrojtjes që i është nevojitur, përbënin një ndërhyrje në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Më tej, në të njëjtën rast, ajo gjykatë do të konstatojë se: “shtetet janë të detyruara të krijojnë një mjedis të favorshëm për pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara në debatet publike, duke u mundësuar atyre të shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa frikë (*Dink v. Turkey*, § 137)”, si dhe se askush nuk do të cenojë sigurinë e tyre gjatë transmetimit të informacioneve me karakter publik.”

Gjithashtu, një nga dokumentet e rëndësishme të Këshillit të Evropës është Rekomandimi CM/Rec(2016)4 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për mbrojtjen e gazetarëve dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik, në Pjesën II. Parimet e pikës 21 është theksuar:

“Dimensioni thelbësor përfshin detyrimin primar për shtetin për të garantuar të drejtën e jetës në një mënyrë që të vendosë dispozita efektive penale me të cilat do t’i pengojnë ata nga kryerja e veprimeve ndaj individëve, të mbështetur nga një aparat shtrëngues për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin për shkeljen e dispozitave të tilla. Kjo, po ashtu, në rrethana të përshtatshme, shtrihet edhe në detyrimin pozitiv të autoriteteve për të marrë masa parandaluese operative për të mbrojtur individët - jeta e të cilëve është në rrezik nga aktivitetet kriminale të individëve të tjerë. Duke pasur parasysh vështirësitë në krijimin e politikave në shoqëritë moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe vendimet operative që duhet të merren në përputhje me prioritetet dhe burimet, fushëveprimi i detyrimit pozitiv duhet të interpretohet në një mënyrë që të mos imponojë një ngarkesë të pamundur ose në disproporcion të autoriteteve. Pavarësisht çdo gjëje, autoritetet duhet t’i kushto-

“një vëmendje pozitive së cenueshme në të cilën vendosen gazetarët për të mbuluar tema të ndjeshme politike vis-a-vis atyre në pushtet.”

Se siguria e gazetarëve është e një rëndësie të madhe, tregon edhe fakti se në kuadër të Këshillit të Evropës që nga dhjetori i vitit 2014 funksionon Platforma për Promovimin e Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve⁴⁸. Kjo platformë është një hapësirë publike ku regjistrohen, përpunohen dhe publikohen incidentet dhe rreziqet që lidhen me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të garantuara me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qëllimi i kësaj Platforme është mbrojtja e gazetarëve dhe adresimi i problemeve tek institucionet përkatëse brenda shteteve anëtare. Lidhur me ngjarjet e datës 27.04.2017, SHGM-ja ka raportuar për një ngjarje në të cilën dy gazetarë janë sulmuar fizikisht në Kuvend⁴⁹.

Çfarë do të thotë e gjithë kjo për analizën e “E Enjtes së Përgjakshme”? Paraprakisht vetëm shkurtimisht, një rikujtim i gjendjes faktike: zyrtar policorë të pamjaftueshëm (në ambientet e jashtme) para Kuvendit për të parandaluar një turmë të tillë, ndihma e një deputeti të atëhershëm për heqjen e mbrojtjes së derës së hyrjes së Kuvendit dhe hapjen e deryve, që të hyjë e gjithë turma, hedhja e gjësendeve drejt gazetarëve në Qendrën e shtypit, maltretimi i gazetarëve, zbulimi se për cilën media punojnë me qëllim për t’i sulmuar, gazetarë të mbyllur me forcë në ambiente dhe ndërhyrja e shtetit pas 3 orësh pasi turma hyri në Parlament.

Mbi fakte kaq të thjeshta, zbatimit të së drejtës vendase dhe standardeve të GJED-NJ pranë Këshillit të Evropës, mund të konkludojmë se vendi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij pozitiv. Megjithatë, ne kemi një qëndrim të ndryshëm nga Gjykata Themelore Civile Shkup dhe Gjykata e Apelit Shkup, që është liria e shprehjes në aspektin e sigurisë së gazetarëve.

Në aktgjykimin e formës së prerë H MALVP-705/20 të Gjykatës Themelore Civile Shkup, në pjesën e kërkesës për konstatimin e shkeljes së lirisë së shprehjes nga aspekti i sigurisë së gazetarëve, thuhet:

“Në rastin konkret, neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe interpretimi i këtij neni i referohet mundësisht të shprehjes së mendimit të secilit në jetën e përditshme dhe jo në kushtet kur ndodhin akte dhune, siç është ngjarja e datës 27.04.2017. Interpretimi i këtij neni në kushte të tilla si ky, me atë që paditësi si gazetar nuk ka mundur të raportojë, është një interpretim i dispozitës jashtë qëllimit të saj për të cilin është përcaktuar. Në një situatë të tillë, si ajo e datës 27 prill

48 <https://www.coe.int/en/web/media-freedom/the-platform>, prej dt. 16.2.2022

49 Safety of Journalists Platform (2017) «Two reporters injured during storming of Parliament», Skopje, <https://fom.coe.int/alerte/detail/25653705>, prej dt. 16.2.2022

2017, shteti ka detyrimin të kujdeset për shëndetin, jetën dhe pronën e të gjithë personave fizikë dhe subjekteve juridike, ndaj nuk mund të thuhet se shteti nuk i ka mundësuar paditësit dhe personave të tjerë si gazetarë të shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa frikë.”

“Paditësi si gazetar në kuptim të nenit 2 të Ligjit për Media është personi që kryen veprimtari të mbledhjes, analizimit, përpunimit, formësimit dhe klasifikimit të informacioneve që publikohen në media, kështu që nuk ka qenë i kufizuar në këtë të drejtë që buron nga deklaratën e tij se nuk ka tentuar si gazetar të raportojë për ngjarjet dhe të shprehë mendimin e tij gjatë ngjarjeve. Për më tepër, në akte terrorizmi dhe demonstratash, shteti ka për detyrë të mbrojë integritetin njerëzor, ndaj në këtë rast ka qenë i detyruar të sigurojë jetën dhe shëndetin e paditësit si gazetar dhe jo të mbrojë të drejtën e tij gazetareske, në një situatë ku çfarë për atë që ka qenë i akredituar për të raportuar, është ndërprerë nga një veprim i personave të tjerë. Ndaj, kjo Gjykatë vlerëson se fakti që akti terrorist apo demonstrimi publik ka ndodhur në një kohë dhe vend ku paditësi ka ushtruar profesionin e tij gazetaresk, nuk do të thotë ndërhyrje e shtetit në të drejtën e tij, kështu që shteti në parimin e përgjegjësisë objektive – për shkak të llojit të ngjarjes të mund të marrë përgjegjësi për shkeljen e kësaj të drejte. Duhet theksuar se liria e shprehjes është e dyanshme, gazetarët kanë të drejtë të raportojnë dhe qytetarët kanë të drejtë të marrin informacione, kështu që fakti që qytetarët janë penguar të marrin informacion të saktë dhe të detajuar për ngjarjen nuk do të thotë se shteti ka përgjegjësi objektive ndaj tyre për shkeljen e kësaj të drejte”.

“Referimi në nenin 3 të Ligjit për media do të thotë se liria e shprehjes është një e drejtë që ushtrohet pa ndërhyrje nga autoriteti publik. Çdo kufizim, kusht ose çdo formë e ndërhyrjes në lirinë e shprehjes mund të zbatohet vetëm për një ushtrim specifik të kësaj lirie. Ndërhyrja e shtetit duhet parë si çdo formë ndërhyrjeje që vjen nga çdo organ që kryen autoritet dhe detyra publike, shërbimi publik (gjykatat, prokuroria, organet e ndjekjes, Parlamenti, Ministritë, pushteti vendor, organet ushtarake, shërbimet e inteligjencës etj.), vëllimi i ndërhyrjes së mundshme (formalitetet, kushtet, kufizimet ose dënimet) në realizimin e së drejtës është e gjerë dhe nuk ka kufizime të paracaktuara, ndaj gjykata në çdo rast të veçantë shqyrton nëse ka ndërhyrje nëpërmjet gjykimeve penale, gjobave, mjeteve të ndalimit të mendimit, ndalimit për kryerjen e veprimtarisë gazetareske etj. Për sa i përket lirisë së shtypit, shteti ka një detyrim pozitiv për të marrë masa për të mbrojtur individët nga ndërhyrja e paligjshme e të tjerëve dhe detyrime negative për t’u përmbajtur nga ndërhyrja e paligjshme në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.”

Nga ky konkluzion i Gjykatës Themelore Civile, krijohet përshtypja se gazetarit, për shkak se nuk i është kufizuar e drejta për të mbledhur dhe transmetuar informacion për një ngjarje të dhunshme, shteti nuk i ka shkelur detyrimin e tij pozitiv - të krijojë një atmosferë të sigurt.

Por, ky nuk është fokusi dhe qëllimi që e jep neni 10, ndër të tjera, është e **siguria** e jo vetëm e drejta për të mbledhur, për të dhënë informacion ose për të shprehur opinione.

Pra, ngjarja nuk kishte asnjë ndryshim nga ditët e mëparshme kur u raportua para dhe në Kuvend. Brenda Kuvendit ishte një atmosferë normale parlamentare. Gazetari-paditës ishte prezent në Kuvend dhe duke ditur se jashtë ka demonstrata publike, ai nuk ka ndjerë frikë, sepse e di që shteti e ka monopolin e përdorimit të forcës dhe nëse ndodh ndonjë akt i padëshiruar i nxehtësisë, shteti ka aftësinë për të shpërndarë dhe për t'u u marrë me turmën. Askush në atë kohë nuk ka pasur frikë për sigurinë e tyre, pasi nuk kanë mundur ta marrin me mend se shteti nuk do të merrte masa paraprake për të parandaluar hyrjen e turmës në Parlament. Përkundrazi, ndjekja penale e personave të caktuar vetëm e vërteton faktin se kjo ishte e organizuar dhe se shteti nuk kishte planifikuar të merrte masa parandaluese.

Në fakt, këtu ka shkelje të lirisë së shprehjes për sa i përket sigurisë së gazetarëve. Mosmarrja e masave paraprake nga monopoli i përdorimit të forcës - shteti, jo nëse gazetarët kanë mundur të raportojnë. Në një situatë të tillë, instinkti i tyre njerëzor ishte të shpëtonin veten, e të bënin intervista me turmën apo të transmetonin drejtpërdrejt atë që po ndodhte. Nuk ka rëndësi nëse gazetarë të caktuar atë ditë transmetonin drejtpërdrejt atë që po ndodhte në Kuvend, në kurriz të jetës së tyre personale. Çështja është se shteti nuk e ka marrë përsipër obligimin e tij pozitiv – të sigurojë Kuvendin dhe të mos lejojë hyrjen e turmës në Kuvend. Diçka që dështoi, që është një fakt famëkeq dhe kjo e bën e cenimin e lirisë së shprehjes.

5.1.3. Aktgjykime të tjera

Por jo gjithçka është aq zi. Mirëpo, ka një vendim të Gjykatës së Apelit në Shkup, të njëjtë për “Të enjten e përgjakshme”, por për një gazetar tjetër, me të cilin revokohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Civile Shkup, me të cilin refuzohet padia e gazetarit për të dyja bazat. Për shkeljen e lirisë së shprehjes, Gjykata e Apelit në Shkup do të nënvizojë:

“Pretendimet ankimore të paditëses janë të bazuara në pjesën e padisë së refuzuar për dëmin jomaterial për shkak të cenimit të lirisë së shprehjes. Përkatësisht, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e padisë mbi këtë bazë me arsyetimin se në rastin përkatës nuk mund të bëhet fjalë se shteti nuk i ka lejuar të gjithë personat të shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa frikë duke iu referuar nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar se interpretimi i kësaj dispozite është jashtë fushëveprimit të saj për të cilin është përcaktuar sepse ka qenë e padiskutueshme që paditësja si gazetare në periudhën në vijim ka raportuar për ngjarjet dhe e ka shprehur mendimin e saj në emisione debative.”

“Mirëpo, gjykata në këtë rast nuk e ka vlerësuar mjaftueshëm se nuk bëhej fjalë për kërkesën e paditëses për shkak të pamundësisë së shtetit për të shprehur lirisht mendimin dhe idetë e saj për ngjarjen, por se në rastin e paditëses nuk i janë siguruar kushte sigurie që ajo si gazetare të mund të zhvillonte veprimtarinë e saj gazetareske dhe të raportojë pa pengesa publikun për atë që ndodhi në ditën kritike në ambientet e Kuvendit. Kjo është aq më tepër që zbatimi i nenit 10 të Konventës Evropiane është në korrelacion me aplikimin e Platformës për Promovimin e Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve për shkak të të cilës në këtë drejtim Gjykata jo mjaftueshëm ka vlerësuar se neni 10 i Konventës duhet të zbatohet në spektër më të gjerë, duke përfshirë jo vetëm lirinë e mediave, por edhe sigurinë e tyre dhe në atë drejtim për të vlerësuar nëse në ditën kritike shteti ka ofruar një atmosferë normale dhe rrjedhimisht të sigurt për kryerjen pa probleme të veprimtarisë gazetareske të paditëses, nëse ajo ka ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen e integritetit të saj fizik apo mendor. Gjykata ka pranuar se nuk është vënë në pikëpyetje liria e shprehjes së paditëses për ngjarjet sepse ajo e ka ushtruar këtë liri në emisionet debative në ditët në vijim, por në këtë rast konkret, sipas kësaj gjykate, mbetet e paqartë nëse ajo ka pasur mundësi ta ushtrojë këtë liri në ditën kritike, nëse për shkak se i ishte rrezikuar siguria dhe iu mohuar kjo e drejtë që, nga ana tjetër, është thelbësore për këtë kontest civile.”

Njëherësh, me vetë aktvendimin, Gjykata e Apelit në Shkup i jep udhëzime Gjykatës Themelore Civile Shkup nga sfera e sigurisë, si vijon:

“...Njëherësh, gjykata duhet të vlerësojë zbatimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të përcaktojë nëse paditësja ka pësuar dëm jomaterial në këtë rast për shkak të shkeljes së lirisë së shprehjes, më saktë nëse shteti ka i krijuar kushtet në ditën kritike që “të kryejë në mënyrë të sigurt veprimtarinë e saj gazetareske dhe të informojë lirshëm publikun, pa pengesa për rrethanat në ambientet e Kuvendit, pa u kujdesur për sigurinë e saj dhe duke ushtruar kështu të drejtën e shprehjes së lirë.”

Nga ky arsyetim i Gjykatës së Apelit Shkup duket se, megjithatë, ka mendim të kundërt nga konkluzionet e Gjykatës së Apelit në rastin H MALVP-705/20, që u analizua më lart. Por, pikëpamjet e tilla të ndryshme të së njëjtës Gjykatë të Apelit në Shkup, krijojnë pasiguri juridike. Pasiguria juridike është frika nga praktika gjyqësore e pabarabartë për të njëjtën situatë faktike dhe juridike, e cila krijon konfuzion në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Prandaj, nevojitet trajnim i vazhdueshëm i gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve publikë dhe monitorim i vazhdueshëm i zhvillimit të konceptit të lirisë së shprehjes, veçanërisht përmes vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës.



KONKLUSIONE

Një nga konkluzionet kryesore që del nga intervistat e kryera dhe analiza e kornizës juridike dhe praktikës gjyqësore është se rreziku i dhunës, presionit dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik ndikon në cilësinë e punës së tyre. Ata që kanë përjetuar dhunë të drejtpërdrejtë tregojnë për pasojat e saj, respektivisht ndikim në gjendjen e tyre psikologjike, auto-censurën dhe punën profesionale në përgjithësi. Gratë po përballen gjithnjë e më shumë me forma të ndryshme ngacmimesh, ofendimesh dhe presionesh, veçanërisht në rrjetet sociale.

Ndikimi më i gjerë i sulmeve të tilla është se ato krijojnë një kulturë të vetë-censurës në media dhe shoqëri. Në një nivel më të gjerë shoqëror, auto-censura rezulton në barriera të rëndësishme për informimin e vërtetë publik. Kjo, nga ana tjetër, çon në uljen e besimit të publikut në institucionet demokratike, duke përfshirë mediat, dhe një rritje të përdorimit të rrjeteve sociale si burim relevant informimi, megjithëse në masë të madhe atje plasohen dezinformata, përmbajtje manipuluese etj.

Prandaj, sa më shumë që gazetarët t'i përmbahen etikës së profesionit të tyre, aq më e fortë është nevoja për të mbrojtur të drejtat dhe sigurinë e tyre gjatë kryerjes së detyrës së tyre profesionale.

Incidentet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill 2017 jo vetëm që tregojnë për keqpërdorim të rëndë të të drejtave elementare të njeriut dhe qytetarit, por, më e rëndësishmja, i theksojnë mospërputhjet në veprimet e institucioneve dhe implikimet sa u përket të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. SHGM-ja propozoi projekt-ndryshim të Kodit Penal, me qëllim të forcimit të mbrojtjes së gazetarëve dhe punëtorëve tjerë të mediave duke i vendosur ata në grupin e profesioneve që do të kishin mbrojtje shtesë kur u ekspozohen sulmeve dhe kërcënimeve për shkak të natyrës së punës së tyre. Në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut thuhet se “shoqatat kombëtare dhe ndërkombëtare të mediave kanë vërejtur se kërcënimet nga politikanë dhe zyrtarë publikë, maltretimi online dhe sulmet verbale ndaj gazetarëve, duke përfshirë edhe rrjetet sociale, janë shtuar. Autoritetet/gjyqësori duhet të demonstrojnë një dënim më aktiv dhe sistematik të sulmeve”⁵⁰.

Nëse nisemi nga përkufizimi i UNESCO-s se siguria është një kategori më e gjerë që shtrihet nga masat parandaluese, mbrojtëse dhe kontrolluese, përmes ballafaqimit me mosndëshkimin dhe promovimin e një kulture shoqërore që nxit lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave, atëherë Republika e Maqedonisë së Veriut para

50 Komisioni Evropian, Raport për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, qasur në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en, prej dt. 27.01.2022

saj ka ende një rrugë të gjatë për të bërë në procesin e sigurimit të mbrojtjes adekuate për gazetarët dhe punonjësit mediatik.

Është e qartë se liria e shprehjes, si koncept, nuk është e përfaqësuar sa duhet si pjesë e formimit profesional të të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë. Kjo nuk vlen vetëm për rastin konkret të analizuar më sipër, por edhe për avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët publikë. Dhe jo vetëm ky shembull, për sa i përket sigurisë së gazetarëve, si pjesë e konceptit të lirisë së shprehjes, por ka segmente të tjera për të cilat nuk ka trajnim të mjaftueshëm, si për shembull shpifja dhe fyerja, roli i gazetarisë në shoqëri, mbrojtja e burimit të informacioneve, nëse veprimet konkrete të gazetarëve janë vepra penale gjatë zbulimit të informacioneve të caktuara që shteti i konsideron konfidenciale etj.

Një rast i tillë gjyqësor në të ardhmen mund të krijojë të ashtuquajturin “Efekt ftohës” ose “chilling effect “. Kjo do të thotë se një vendim i tillë vetëm mund t’i dekurajojë gazetarët në ngritjen e padive në të ardhmen në situata kur siguria e tyre është cenuar në një atmosferë paqësore. Dhe jo vetëm padi kundër shtetit, por edhe padi ndaj individëve që do të cenonin integritetin psikofizik të gazetarëve.

Duhet të bëhet një edukim më i madh për konceptin e lirisë së shprehjes, përkatësisht sigurisë së gazetarëve, sepse çdo ditë ndodh që ajo të rrezikohet në mungesë të lëndimeve trupore. Kërcënimet janë një frikë reale, e cila ekziston dhe e cila dekurajon profesionin e gazetarit në kryerjen e funksionit të tij themelor – mbledhjen, analizimin dhe transmetimin e informacioneve me interes publik.

Mangësia më e madhe në funksionimin e sistemit tonë gjyqësor është fakti që gazetarët janë lënë vetëm për të mbrojtur të drejtat e tyre përmes mekanizmit juridik-civil. Prokuroritë Publike themelore nuk janë aspak të zellshme në trajtimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe cenimit të sigurisë së tyre. Nevojitet hetim efektiv dhe masa parandaluese për të dekurajuar autorët e këtyre krimeve dhe vetëm në këtë mënyrë shteti do të krijonte një atmosferë të sigurt në të cilën gazetarët do të mund të kryejnë plotësisht profesionin e tyre.



REKOMANDIME

- Duhet të zbatohet një trajnim gjithëpërfshirës i policisë, avokatëve, prokurorëve publikë dhe gjyqtarëve për rolin e gazetarëve, bashkëpunëtorëve mediatik dhe mediave në një shoqëri demokratike. Aq më tepër që me ndryshimet në Kodin Penal, atyre u njihet statusi i personave zyrtarë. Kjo do të thotë se organet e zbatimit të ligjit, në raste të caktuara, duhet të veprojnë në mënyrë parandaluese në mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve dhe bashkëpunëtorëve mediatik, kurse veprim parandalues do të thotë hetim efektiv.
- Nevojiten përpjekje të përbashkëta ndërmjet aktorëve të ndryshëm në shoqëri, gjegjësisht mediave, publikut, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve shtetërore në inicimin e aktiviteteve strategjike që synojnë adresimin efektiv të çështjeve që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Në këtë mënyrë do të mund të koordinohen iniciativat e ndryshme që synojnë mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe do të mund të sigurohet progres në adresimin e kësaj çështjeje në planin afatgjatë.
- Krijimi i një fondi sigurie dhe mekanizmave të reagimit emergjent për të mbështetur gazetarët dhe punonjësit mediatik të rrezikuar.
- SHGM të marrë në vazhdimësi mbështetje në ofrimin e shërbimeve për mbështetjen e gazetarëve dhe punëtorëve mediatik, përmes këshillimit, këshillimit juridik dhe përfaqësimit, mbështetjes psikologjike, si dhe “vend strehimeve” apo çdo strehim tjetër të përshtatshëm për gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave që janë bërë viktimë të dhunës, krimit etj...
- Organizimi i trajnimeve për sigurinë e gazetarëve dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat përballen si pjesë e programeve/projekteve të zhvillimit profesional që i zbatojnë organizatat profesionale/mediatike.
- Organizimi i trajnimeve për përfaqësuesit e gjyqësorit për lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve.
- Përpilimi i udhëzimeve/orientimeve në redaksi për sigurinë e gazetarëve ose shfrytëzimi i udhëzimeve/rekomandimeve nga SHGM.
- Redaksitë duhet të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin e pronarëve, drejtorëve dhe gazetarëve dhe të zbatohen mekanizmat e brendshëm të emergjencës, siç janë linjat telefonike për shqetësimin online, për të ofruar mbështetje dhe mbrojtje për gazetarët dhe punonjësit mediatik që preken drejtpërdrejt nga kërcënimet, presionet dhe shqetësimet.

- Të krijohen rrjete/aleanca për shkëmbimin e praktikave më të mira. Në këto rrjete do të përfshiheshin redaktorë, menaxherë mediash, ekspertë mediash, përfaqësues të organizatave mediatike, ekspertë të sigurisë digjitale, juristë, si dhe gazetarë, ekspertë ndërkombëtarë etj.
- Redaksitë duhet të ndajnë më shumë hapësirë dhe të raportojnë rregullisht dhe të mbulojnë në thellësi temat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në ndërgjegjësimin e publikut të gjerë, zyrtarëve qeveritarë dhe vetë gazetarëve.
- Monitorim i vazhdueshëm i sigurisë së gazetarëve dhe reagim në kohë, me metodologji dhe mjete të përcaktuara të grupuara sipas kategorive të veçanta të dhunës.
- Realizimi i fushatave për ngritjen e ndërgjegjes publike, të cilat do të ndihmonin për të kuptuar se nuk bëhet fjalë për një sulm ndaj një individi apo një grupi njerëzish të një profesioni, por për një të drejtë të qytetarëve për t'u informuar.
- Dënim publik i incidenteve të rënda nga bartës të funksioneve publike, veçanërisht nga autoriteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, me qëllim që të dekurajohen sulmet e ardhshme.

www.znm.org.mk

Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)

Gradski Zid, blok 13 1000, Skopje, Republika e Maqedonisë së Veriut
00389 (02) 3298-139 contact@znm.org.mk



unesco

United Nations
Educational, Scientific
and Cultural Organization



Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

